

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i
Drejtësisë



Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani
@ILD_Albania

ANKETA MBI PUNËN E ILLD-SË, NJË MEKANIZËM MONITORIMI I INSTITUCIONIT NGA QYTETARËT

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ÇESHTJEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I NDHIMËS JURIDIKE DHE ANKESAVE

Anketë mbi veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

Në kuadër të rritjes së besimit të publikut, si dhe për përmirësimin e punës në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është hartuar "Anketa mbi veprimtarinë e ILLD-së" në mënyrë që çdo qytetar të ndajë përvojën personale mbi shërbimin e ofruar. ILLD do vlerësojë me seriozitet çdo sugjerim/kritikë ose vlerësim, prandaj kërkohet mirëkuptimi juaj për 11 kushuar 3 (tre) minuta kohë plotësisht të këtij pyetësi.

Qëllimi i anketimit është:

- Orientimi i veprimtarisë së ILLD-së, në pajtim me nevojat e publikut;
- Forcimi i besimit të qytetarëve tek puna e ILLD-së;

1. Sa i informuar jeni mbi funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë? Zgjidhni një ose disa nga pohimet e mëposhtme.

- Njoh pak sferën e kompetencave të ILLD-së.
- Njoh kompetencat e ILLD-së, pasi kam lexuar kuadrin ligjor të sistemit të drejtësisë. (2)
- Jam informuar përmes faqes zyrtare të ILLD-së. (3)
- Jam informuar nëpërmjet mediave tradicionale/sociale për ILLD-në. (4)
- Më kanë informuar të njohur/institucione publike, mbi mundësinë e ankimit ndaj veprimtarisë së magjistratëve pranë ILLD-së.
- Kam dashur por nuk kam njohur asnjë nga format e komunikimit

2. A jeni ankuar ndonjë herë për veprimtarinë e magjistratëve? Po, ankohem për herë të parë në ILLD.

- Po, ankohem për herë të parë në ILLD. (1)
- Po, kam depozituar ankesë edhe më parë. (2)
- Jo asnjëherë

an
Fr
Se
Te
Si

anketa
From:
Sent:
To:
Subject:

ILD Anketë <info@ild.al>
Wednesday, September 14, 2022 11:43 AM
anketa
Anketa

1. Sa i informuar jeni mbi funksionimin e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë? Zgjidhni një ose disa nga pohimet e mëposhtme.

Njoh kompetencat e ILLD-së, pasi kam lexuar kuadrin ligjor të sistemit të drejtësisë. (2)

2. A jeni ankuar ndonjëherë për veprimtarinë e magjistratëve? Jo, ankohem për herë të parë në ILLD.

Jo, ankohem për herë të parë në ILLD. (1)

3. A keni përdorur ndonjëherë një ose disa nga format e komunikimit me ILLD-në, për ankesa apo informacion? Nëse po, mund të zgjidhni një ose disa nga pohimet e mëposhtme:


Kontakti fizikisht në ILLD, në orarin 09.00-14.00 nga e hëna në të premtë. (4)

4. A e keni vizituar faqen zyrtare të internetit <http://www.ild.al>? E kam vizituar dhe jam orientuar në lidhje me procedurat e ankimit dhe veprimtarinë e ILLD-së.

E kam vizituar dhe jam orientuar në lidhje me procedurat e ankimit dhe veprimtarinë e ILLD-së. (1)

5. Sa i dobishëm ka qenë për ju informacioni rreth procedurës së ankimit nëpërmjet faqes zyrtare të internetit <http://www.ild.al>? I dobishëm, pasi kam marrë informacione në lidhje me plotësimin e formularit të ankesës.

I dobishëm, pasi kam marrë informacione në lidhje me plotësimin e formularit të ankesës. (1)



ANKETA MBI PUNËN E ILD-SË, NJË MEKANIZËM MONITORIMI I INSTITUCIONIT NGA QYTETARËT

Një vit më parë, në ditën e drejtësisë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë publikoi anketën mbi veprimtarinë e institucionit, si një mënyrë e brendshme komunikimi, për të vjelë në mënyrë direkte mendimet e qytetarëve, që kanë pasur eksperiencë apo jo me ILD-në.

Qytetarët janë pyetur mbi njohuritë që kanë mbi funksionet e ILD-së, nëse kanë pasur eksperiencë me të, cilësinë e komunikimit me institucionin, adresimin e ankesës së paraqitur, si dhe punën e ILD-së në këto tre vite, bazuar në kontaktet me institucionin apo përmes mesazheve në media e rrjetet sociale.

91 anketa janë plotësuar online dhe fizikisht pranë institucionit, të cilat krahas vlerësimit për korrektesën e ILD-së për komunikim dhe asistencën e ofruar gjatë procesit të ankimimit,

kanë përcjellë edhe sugjerime, që kanë të bëjnë me afatet e shqyrtimit të ankesave, rritjen e numrit të inspektorëve e vetë kompetencave të institucionit, si dhe më specifiku, rritjen e inspektimeve në prokurori apo gjykata, për të kontrolluar veprimtarinë e magistratëve, prokurorë e gjyqtarë, në funksion të zbatimit të ligjit procedural, në përmirësimin e punës së institucionit.

Në vitin e parë të anketës mbi punën e ILD-së, Inspektori i Lartë të Drejtësisë falënderon qytetarët dhe përdoruesit e sistemit të drejtësisë, që u përfshinë në dhënie të mendimeve dhe i siguron se çdo vërejtje është mbajtur shënim dhe do reflektohet në përmirësimin e punës së institucionit.

Anketa do jetë një seksion permanent në faqen

- Institucion, që duhet të përmirësohet për të rritur besueshmërinë e publikut tek sistemi i drejtësisë. (1)
- Institucion nga i cili presim rezultate më domethënëse, në verifikimin e veprimtarisë së magistratëve.

Udhëzime mbi përmirësimin e punës së ILD:

Një muaj më parë kam dorëzuar ankese me ILD në Sektorin e ankesave të çelët me Kompetencat e ILD dhe kam degjuar shumë denoncimet problematike të cilat më kanë bërë të mundur të marrë një përfundim brenda afatit të kësaj pune.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

ndërojmë për kohën tuaj!

- Institucion nga i cili presim rezultate më domethënëse, në verifikimin e veprimtarisë së magistratëve.

Udhëzime mbi përmirësimin e punës së ILD:

Është i nevojshëm institucion që të sigurojë hapësirë të hapur dhe të sigurojë hapësirë të hapur të qytetarëve të cilët kanë bërë të mundur të marrë një përfundim brenda afatit të kësaj pune.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

ndërojmë për kohën tuaj!

zyrtare të institucionit, si një mënyrë komunikimi e pandërprerë, që do mundësojë një monitorim direkt të punës së institucionit nga çdo qytetar.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë bën të ditur se përveç procesit të ankimimit, që padyshim ka vëmendjen më të madhe të qytetarëve, i ka kushtuar vëmendje edhe inspektimit, dimensionin

tjetër i punës së ILD-së. Plani i inspektimit për vitin 2023 parashikon katër inspektime tematike në gjykata dhe prokurori në mbarë vendin, me objekt ndarjen e çështjeve me short dhe kontroll të raporteve të sistemit elektronik, procedurën e shpalljes së arsyetimit të vendimeve gjyqësore dhe caktimin e çështjeve. Plani i inspektimeve për vitin 2023 gjendet i publikuar në faqen zyrtare të ILD-së.

- Institucion nga i cili presim rezultate më domethënëse, në verifikimin e veprimtarisë së magistratëve. (3)

Udhëzime mbi përmirësimin e punës së ILD:

Duhet të ketë ndërkombëdit të cilat mund të sigurojnë hapësirë të hapur të qytetarëve të cilët kanë bërë të mundur të marrë një përfundim brenda afatit të kësaj pune.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

ndërojmë për kohën tuaj!

Udhëzime mbi përmirësimin e punës së ILD-së:
 Duhet të ketë ndërkombëdit të cilat mund të sigurojnë hapësirë të hapur të qytetarëve të cilët kanë bërë të mundur të marrë një përfundim brenda afatit të kësaj pune.

Udhëzime mbi përmirësimin e punës së ILD-së:

Është i nevojshëm institucion që të sigurojë hapësirë të hapur dhe të sigurojë hapësirë të hapur të qytetarëve të cilët kanë bërë të mundur të marrë një përfundim brenda afatit të kësaj pune.



DITA KOMBËTARE E DREJTËSISË, MESAZH URIMI I INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË

Sot, në ditën Kombëtare të Drejtësisë, uroj çdo gjyqtar e prokuror, çdo jurist, që përpiqet çdo ditë të respektojë e zbatojë ligjin.

Por sot, më shumë sesa të festojmë, duhet të kuptojmë se sa i rëndësishëm është profesioni ynë, detyra që ushtrojmë, përgjegjësia që kemi përpara qytetarëve dhe të ardhmes. Më shumë akoma të jemi të ndërgjegjshëm, se njerëzit shpresojnë tek shteti ligjor, shpresojnë tek institucionet e drejtësisë, njerëzit shpresojnë tek ligji dhe barazia para tij.

Kjo shpresë nuk duhet vrrarë!

Nëse gjyqtarët e prokurorët, e bashkë me ta, edhe ne të tjerët, do t'i rezistojmë përpjekjeve të interesave politike, financiare e të tjera, që kërkojnë të imponojnë vendim-marrjen dhe paanësinë, nëse do të ruajmë të pastra interesat e dhënies së drejtësisë, atëherë i kemi bërë një shërbim të çmuar shoqërisë, demokracisë, të ardhmes së fëmijëve tanë, vendit tonë.

Nëse gjyqtarët e prokurorët, e bashkë me ta, edhe ne të tjerët, do t'i rezistojmë përpjekjeve të interesave politike, financiare e të tjera, që kërkojnë të imponojnë vendim-marrjen dhe paanësinë, nëse do të ruajmë të pastra interesat e dhënies së drejtësisë, atëherë i kemi bërë një shërbim të çmuar shoqërisë, demokracisë, të ardhmes së fëmijëve tanë, vendit tonë



ILD PËRFUNDON VERIFIKIMIN PËR RASTIN E SHTETASIT DAN HUTRA

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka përfunduar verifikimin e nisur kryesisht, të informacionit të bërë publik në media, lidhur me ngjarjen e rëndë të ndodhur në Tiranë më 1 Mars 2023, ku si pasojë e veprimeve të kryera nga shtetasi Dan Hutra, 3 gra kanë humbur jetën dhe janë plagosur tre të tjera, ndër të cilat, bashkëjetuesja e tij.

ILD vlerëson paraprakisht se faktet (veprimet apo mosveprimet e magjistratit), të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, nuk janë vetëm ato që parashtrihen në bazë të një informacioni publik, por janë ato që analizohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, apo vlerësohen në bazë të një procesi verifikimi apo hetimit disiplinor.

Në bazë të një informacioni publik mund të paraqiten një tërësi faktesh, të cilat pretendohet se kanë ndodhur dhe që përbëjnë shkelje disiplinore, por Inspektori i Lartë i Drejtësisë, mund të bëjë një

cilësim të saktë apo të ndryshëm të fakteve dhe veprimeve, që lidhen me shkeljen disiplinore, pa u lidhur me përcaktimin, që mund të pretendohet në këtë informacion publik.

Në funksion të verifikimit të këtij rasti, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka administruar të dhëna shtesë dhe dokumentacionin përkatës nga Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe nga Drejtoria e Burgjeve.

- Nga verifikimet e kryera mbi informacionet mediatike për lirimin nga burgu të shtetasit Dan Hutra, rezultojnë se lirimi është rrjedhojë e një procesi gjyqësor me objekt “Kërkesë për shuarje mase sigurimi”, dhe vendimmarrja e gjyqtarit G.H. ka qenë në përputhje me

ligjin, pasi i dënuari kishte përmbushur periudhën e dënimit me qëndrimin në paraburgim.

- Nga verifikimet e kryera mbi informacionet mediatike lidhur me gjykimin e shkurtuar për shtetasin Dan Hutra, për veprën penale “Dhunë në familje”, rezulton se gjyqtari G. H. në ushtrim të kompetencave të tij për çmuarjen e vlefshmërisë së një akti procedural, sipas rregullimit përkatës në Kodin e Procedurës Penale, ka përfshirë edhe qëndrimin e të pandehurit për njohje të kërkesës së prokurorit R.K., duke pranuar gjykimin e shkurtuar, si gjykim në gjendjen e akteve të ndodhura në fashikullin e prokurorit me zgjedhjen e të cilit, i pandehuri heq dorë nga debati për provat, kërkesat për pavlefshmëri, duke pranuar që të gjykohej mbi bazën e të dhënave të marra në fazën e hetimeve paraprake, e përfituar për rrjedhojë ulje në masën 1/3 të dënimit, nëse dënohet.
- Nga verifikimet e kryera mbi informacionet mediatike për masën e dënimit të Dan Hutrës me 1 vit e 6 muaj burg, rezulton se kërkesa e prokurorit dhe vendimmarrja e gjyqtarit janë konform diskrecionit ligjor të magjistratit, në përcaktimin e masës së dënimit, bazuar në faktet e përcjella, përfshi dënimin e mëparshëm të të pandehurit për vrasjen e bashkëshortes së tij dhe marzhin e sanksionit, që legjislatori ka përcaktuar për veprën penale “Dhunë në familje” (Neni 130/a/1 i Kodit Penal), vendimmarrje e konfirmuar edhe në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
- Në lidhje me mosadministrimin e dëshmisë së penaltetit, referuar analizës për individualizimin e dënimit, në kushtet kur në kuadër të rrethanës rënduese sipas nenit 50/1/ç të Kodit Penal, është marrë në konsideratë dënimi i mëparshëm i të pandehurit lidhur

me vrasjen e bashkëshortes së tij, çmohet se mungesa e konstatuar e administrimit të dëshmisë së penaltetit nuk mund të vlerësohet si mospërmbushje e funksionit gjatë gjykimit, në kuadër të shkeljes disiplinore sipas përcaktimeve të nenit 101 dhe neni 102, pika 1 shkronja “ç” e ligjit me nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në analizë të dokumentacionit të administruar rezultoi se në lidhje me procedurat ligjore të ndjekura gjatë hetimit, gjykimit apo fazës së ekzekutimit të çështjes penale të regjistruar në vitin 2022, në emër të shtetasit Dan Hutra për kryerjen e veprës penale “Dhunë në familje”, të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, si dhe procedurat ligjore të ndjekura gjatë hetimit, gjykimit apo fazës së ekzekutimit të çështjeve të tjera të mundshme penale të regjistruara në emër të shtetasit Dan Hutra, nuk konstatohen veprime apo mosveprime të magjistratëve, të cilat i krijojnë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, një dyshim të arsyeshëm, i cili justifikon fillimin e hetimit disiplinor sipas kërkesave të nenit 122, pika 1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në këto kushte, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në mbështetje të nenit 120 dhe 121, pika 2, shkronja “a” e ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 204, pika 1, shkronja “j” dhe neni 2014 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ka vendosur arkivimin pas verifikimit kryesisht të informacionit të bërë publik në media në lidhje me procedurat ligjore të ndjekura gjatë hetimit, gjykimit apo fazës së ekzekutimit të çështjeve penale të regjistruara në emër të shtetasit Dan Hutra.



METANI: REFORMA NUK ËSHTË NJË BETEJË VETËM E INSTITUCIONEVE TË DREJTËSISË

Elbasan, 10 Maj 2023 me Prokurorinë e Rrethit, në kuadër të ditës kombëtare të drejtësisë.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani mori pjesë në tryezën e diskutimit me temë “Sfidat e drejtësisë shqiptare nga Kanuni i Zhurisë deri te reforma në drejtësi, në kuadër të proceseve integruese, kapitulli 23, Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, organizuar nga Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan në bashkëpunim

Në fjalën e tij, “Pavarësia e pushtetit gjyqësor dhe sfida në raport me këtë pavarësi” z. Metani duke u ndalur tek reforma në drejtësi, veçoi mes të tjerash rëndësinë që ka transmetimi tek qytetarët i parimit të ndarjes e balancimit të pushteteve.





“E mbështetur tek parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, reforma në drejtësi ka nevojë që sot ta transmetojë tek qytetarët, tek shoqëria, rëndësinë e zbatimit të këtij parimi. Jo si një mjet për t’iu shmangur përgjegjësive, por si i vetmi standard, që na garanton të ardhmen e pavarësisë së sistemit të drejtësisë. Unë jam i ndërgjegjshëm, që qytetarët me të drejtë kanë pritshmëri dhe janë të lodhur me pritjet në dyert e gjykatave, sot dhe 30 vjet. Ndoshta edhe shoqëria e ka gati të pamundur të përballojë gjendjen e sistemit të drejtësisë sot. Por jam i bindur, se e vetmja mënyrë për të pasur një sistem drejtësie efikas nesër, është që zgjidhjet që japim sot, të zhvishen nga interesi i çastit apo momenti politik. Pavarësia e gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk është një parim për të mbrojtur shkeljet e ligjit, që ata mund të kryejnë, apo pretekst për të anashkaluar përgjegjësinë e tyre ligjore.





Aspak! Por, nëse një Për reformën në gjyqtar ose prokuror vihet para përgjegjësisë së besimit të pub-sot, sepse shoqëria nuk është dakord me vendimin e tij, apo se shoqëria nuk orientohet tek institucionet, të cilat Kushtetuta dhe ligji ka ngritur enkas, pikërisht për trajtimin e pakënaqësive ndaj sistemit gjyqësor, apo më keq akoma, sepse pushtete të tjera duan të përfitojnë nga pamundësia ligjore e reagimit publik të gjyqtarëve dhe prokurorëve, atëherë nuk ka reformë që të ketë sukses, por vetëm zgjatje e agonisë tonë, në përpjekjet për zhvillim.”

Drejtues i Katedrës “Jean Monnet”, EEAABAC, Prof. Asoc. Dr. Arbër Gjeta solli për të pranishmit “Zhvillimet e fundit në kuadër të negociatave në lidhje me kapitullin 23”.

Tryeza u përshëndet nga rektori i Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Prof. Dr. Skënder Topi dhe z. Kreshnik Ajazi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit, si

bashkëorganizues të aktivitetit, si dhe nga dekania e Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Elbasanit Prof. Asoc. Dr. Imelda Sejdini, kryetarja e Gjykatës Elbasan, znj. Matilda Fetau dhe drejtori i policisë së qarkut Elbasan, z. Ilir Poda.

Të pranishmit studentë, gjyqtarë, prokurorë, avokatë, pedagogë, etj., diskutuan rreth temave të trajtuara.





FJALA E PLOTË E Z. ARTUR METANI NË TRYEZËN PËR DITËN KOMBËTARË TË DREJTËSISË

Elbasan, më 10 Maj 2023

Përshëndetje të gjithëve,

Është kënaqësi e veçantë të jem këtu sot me ju dhe dua të falënderoj për zemërsisht organizatorët, sepse Dita Kombëtare e Drejtësisë nuk është vetëm në Tiranë, pasi drejtësia është një temë mbi të cilën është e interesuar dhe duhet reflektuar nga e gjithë shoqëria, jo vetëm institucionet në Tiranë.

Reforma në drejtësi erdhi si nevojë për adresimin e një sërë nevojash dhe problematikash, që paraqiste sistemi i drejtësisë, procedura të gjata, hallka që zgjasnin procedurat gjyqësore në mënyrë të panevojshme, probleme të integritetit profesional, etik dhe moral të gjyqtarëve dhe prokurorëve, çështje të pavarësisë, por edhe të “korporatizmit” të tyre, të evidentuara në shumë raste, etj. Të gjitha këto çështje u adresuan nga

reforma në drejtësi dhe sot sistemi ka një arkitekturë tërësisht të re të organizimit të vet. Por në këndvështrimin tim, kjo reformë krijoi edhe bazamentin për të ndërtuar një filozofi të qëndrueshme dhe afatgjatë për drejtimin e shtetit dhe të shoqërisë, mbështetur në një kolonë shumë të rëndësishme, siç është ajo e ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

Kjo është e rëndësishme të theksohet sipas meje, sepse të gjithë mund të biem dakord, që të operohet sipas këtij parimi, por pyetjet që lindin më pas, lidhen me mënyrën se si duhen ushtruar kompetencat ligjore pikërisht mbi atë parim, pasi mendimet dhe interpretimet janë të tjera nga qytetarët, e krejt të ndryshme nga specialistët.

E mbështetur tek parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, reforma në drejtësi ka nevojë që sot ta transmetojë tek qytetarët, tek shoqëria, rëndësinë e zbatimit të këtij parimi. Jo si një mjet

E vetmja mënyrë për të pasur një sistem drejtësie efikas nesër është që zgjidhjet që japim sot, të zhvishen nga interesi i çastit apo momenti politik. Pavarësia e gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk është një parim për të mbrojtur shkeljet e ligjit, që ata mund të kryejnë, apo pretekst për të anashkaluar përgjegjësinë e tyre ligjore.

për t'iu shmangur përgjegjësive, por si i vetmi kryejnë, apo pretekst për të anashkaluar standard, që na garanton të ardhmen e përgjegjësinë e tyre ligjore. pavarësisë së sistemit të drejtësisë. Unë jam i ndërgjegjshëm, që qytetarët me të drejtë kanë pritshmëri dhe janë të lodhur me pritjet në dyert e gjykatave, sot dhe 30 vjet.

Ndoshta edhe shoqëria e ka gati të pamundur të përballojë gjendjen e sistemit të drejtësisë sot. Por jam i bindur, se e vetmja mënyrë për të pasur një sistem drejtësie efikas nesër, është që zgjidhjet që japim sot, të zhvishen nga interesi i çastit apo momenti politik. Pavarësia e gjyqtarëve dhe prokurorëve, nuk është një parim për të mbrojtur shkeljet e ligjit, që ata mund të kryejnë, apo pretekst për të anashkaluar përgjegjësinë e tyre ligjore. Aspak! Por, nëse një gjyqtar ose prokuror vihet para përgjegjësive sot, sepse shoqëria nuk është dakord me vendimin e tij, apo se shoqëria nuk orientohet tek institucionet, të cilat Kushtetuta dhe ligji ka ngritur enkas, pikërisht për trajtimin e pakënaqësive ndaj sistemit gjyqësor, apo më keq akoma, sepse pushtete të tjera duan të përfitojnë nga pamundësia ligjore e reagimit publik të gjyqtarëve dhe prokurorëve, atëherë nuk ka reformë që të ketë sukses, por vetëm zgjatje e agonisë tonë, në përpjekjet për zhvillim.





Nga ana tjetër, mendoj se ky parim i ndarjes së pushteteve nuk mund të ketë sukses, dhe më pas vetë reforma në drejtësi nuk ka për të patur sukses, nëse ne nuk e kultivojmë drejtësinë si një vlerë shoqërore, nuk e kultivojmë ndarjen e pushteteve, si një sistem që garanton paanësi dhe qetësi. Drejtësia nuk mund të jetë statistikë. Ajo duhet të jetë standard. Gjyqtarët dhe prokurorët vijnë nga kjo shoqëri, që së bashku po përpiqemi të konsolidojmë, me standarde. Pra, edhe magjistratët reflektojnë patjetër të mirat dhe të këqijat e shoqërisë sonë, karakterin dhe problemet tona. Për këtë arsye, mendoj unë, që drejtësia nuk mund të jetë thjesht numra

gjyqtarësh dhe prokurorësh të shkarkuar e proceduar, por vetëm standardesh të kultivuara dhe të vendosura për të ardhmen. Dhe për këtë, reforma nuk është një betejë vetëm e institucioneve të drejtësisë. Padyshim që ato kanë rolin dhe përgjegjësinë më të madhe. Por ajo është përgjegjësi morale e të gjithëve ne, edhe e institucioneve të tjera, e politikës, medias, shoqërisë në përgjithësi, që të kultivojmë sensin e së drejtës dhe të ndarjes së punëve, në një shtet demokratik. Pa patetizëm, kështu mendoj, se secili në hapësirën e vet, i kemi bërë shërbimin më të madh këtij vendi. Ju faleminderit!





METANI: DIALOGU MES PROFESIONISTËVE TË SË DREJTËS SI BASHKËPUNIM EDHE MES SHTETEVE

Vlorë, më 20 Maj 2023
 Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani mori pjesë në Konferencën Ndërkombëtare shkencore “Ligjëratat e Rolando Quadri-t në të Drejtën Ndërkombëtare”, organizuar nga Departamenti i Drejtësisë së Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës.

E konceptuar si ditë studimore në nderim të figurës së juristit të spikatur italian Rolando Quadri dhe kontributit të tij shumëvjeçar në të Drejtën Ndërkombëtare,

konferenca bashkoi profesionistë e studiues të së drejtës, akademikë, përfaqësues institucionalë nga Shqipëria dhe Italia.

Në përshëndetjen e tij për konferencën, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani nënvizoi kënaqësinë personale e profesionale, të të qenit në një mjedis ku diskutimi bëhet në nivel akademik, si një proces tejet i rëndësishëm, që provokon një debat të dobishëm.

Duke iu referuar temës

së aktivitetit, z. Metani tha: “Kur u njoha me programin me këtë aktiviteti, temat në ditët sotme zhvillime diskutimit si dhe min e së drejtës çështjet të cilat do të trajtohen mendimi i parë që më erdhi në mendje kishte të





Ka shumë autorë skeptikë si filozofë, politologë, juristë apo publicistë, të cilët i mohojnë karakterin apo tiparin e së “drejtës pozitive”, të drejtës ndërkombëtare sepse shtetet janë sovraane dhe mbi to nuk mund të ketë të drejtë tjetër, që do të duhet të zbatohet nga ana e tyre. Të drejtës ndërkombëtare i mungojnë karakteristikat e së “drejtës pozitive” por ajo duhet të konsiderohet vetëm si çështje etike apo morali pozitiv ndërkombëtar.”

Inspektori i Lartë i Drejtësisë shprehu

kënaqësinë, që është Shqipëria pikënisja e ndërtimit të një dialogu përmes një konference të tillë.

“Jo vetëm për të ndarë mendimet tona në kuadër të së drejtës ndërkombëtare, por njëkohësisht edhe për të ndarë mendime mbi vlerat që na bashkojnë, raportin që gjithsecili nga ne ka me të drejtën, universalitetin e saj, strukturat institucionale apo dhe bashkëpunimin ndërmjet individëve apo shteteve.”

Ka shumë autorë skeptikë si filozofë, politologë, juristë apo publicistë, të cilët i mohojnë karakterin apo tiparin e së “drejtës pozitive”, të drejtës ndërkombëtare sepse shtetet janë sovraane dhe mbi to nuk mund të ketë të drejtë tjetër, që do të duhet të zbatohet nga ana e tyre.

Të drejtës ndërkombëtare i mungojnë karakteristikat e së “drejtës pozitive” por ajo duhet të konsiderohet vetëm si çështje etike apo morali pozitiv ndërkombëtar



FJALA E Z. METANI NË KONFERENCËN NDËRKOMBËTARE SHKENCORE “LIGJËRATAT E ROLANDO QUADRI-T NË TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE”

E nderuar Zv. Rektore Prof. Frosina Londo;

E nderuar Dekane Prof. Armela Panajoti;

I nderuar Drejtues i Departamentit Dr. Erjon Hitaj;

Të nderuar të ftuar;

Zonja dhe zotërinj,

Përshëndetje të gjithëve!

Dua të përgëzoj organizatorët e kësaj konference për këtë iniciativë të ndërmarrë, si dhe t'i falenderoj për ftesën për të marrë pjesë.

Personalisht vlerësoj se zhvillimi i konferencave të tilla, si dhe diskutimi në nivel akademik përbën në vetvete një proces të rëndësishëm. Kontributi i botës akademike është shumë i vlefshëm pasi provokon një debat të dobishëm.

Sigurimi i një mendimi të kualifikuar profesional, mbështetur në një eksperiencë teorike dhe praktike të studuesve, përbën një mjet kyç për analizimin e plotë të gjendjes aktuale lidhur me tematikën e këtij aktiviteti.

Në të njëjtën kohë, ky proces angazhimi dhe zhvillimi i mendimit të kualifikuar juridik, politik, apo edhe dhe në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare shërben si një mekanizëm për evidentimin e problematikave dhe nevojave për përmirësim.

Kur u njoha me programin me këtij aktiviteti, temat e diskutimit si dhe çështjet të cilat do të trajtohen mendimi i parë që më erdhi në mendje kishte të bënte me skepticizmin që ka ndjekur që nga lashtësia dhe deri në ditët sotme zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare.

Ka shumë autorë skeptikë si filozofë, politologë, juristë apo publicistë, të cilët i mohojnë karakterin apo tiparin e së “drejtës



pozitive”, të drejtës ndërkombëtare sepse shtetet janë sovraane dhe mbi to nuk mund të ketë të drejtë tjetër, që do të duhet të zbatohet nga ana e tyre.

Të drejtës ndërkombëtare i mungojnë karakteristikat e së “drejtës pozitive” por ajo duhet të konsiderohet vetëm si çështje etike apo morali pozitiv ndërkombëtar.

Ndërkohë, Kodifikimi i Përgjithshëm i së

Drejtës Ndërkombëtare nuk është realizuar deri më tani, pasi ajo ka një karakter universal dhe është mëse e sigurt se të gjitha shtetet nuk mund të bien dakord për të gjitha çështjet. Bashkësia ndërkombëtare nuk ka një organ qendror të që bëjë të mundur këtë kodifikim, pasi shtetet sovraane nuk e kanë deleguar këtë të drejtë për të kodifikuar.

Disa studiues e kanë konsideruar statik dhe pengesë për zhvillimin e së drejtës

Sigurimi i një mendimi të kualifikuar profesional, mbështetur në një eksperiencë teorike dhe praktike të studiuesve, përbën një mjet kyç për analizimin e plotë të gjendjes aktuale lidhur me tematikën e këtij aktiviteti. Në të njëjtën kohë, ky proces angazhimi dhe zhvillimi i mendimit të kualifikuar juridik, politik, apo edhe dhe në kuadër të marrëdhënieve ndërkombëtare shërben si një mekanizëm për evidentimin e problematikave dhe nevojave për përmirësim.



ndërkombëtare. Në të një dialog dhe komu-
njëjtën kohë, aspekti nikim të vazhdueshëm
krahasues do të ndërmjet nesh si akad-
mbetet gjithnjë pjesë e emikë dhe si profesion-
diskutimeve rreth nor- istë të së drejtës. Jo
mave, institucioneve vetëm për të ndarë
dhe aktorëve të së mendimet tona, në
drejtës ndërk- kuadër të së drejtës
ombëtare. ndërkombëtare, por

Në këtë kuadër aftësia të ndarë mendime mbi
për kodifikim ka vlerat që na bashkojnë,
mbetur në vetë raportin që gjithsecili
shtetet, të cilat e bëjnë nga ne ka me të
këtë nëpërmjet konfer- drejtën, universalitetin
encave apo takimeve e saj, strukturat institu-
ndërkombëtare. cionale apo dhe bash-
këtë arsye e vlerësoj këpunimin ndërmjet
shumë këtë konfer- individëve apo
encë. Sot, nëpërmjet shteteve. Shpresoj që
kësaj konference, do të ky organizim në
zhvillojmë e ndërtojmë Shqipëri sot, të jetë

pikënisja e një tradite, e cila do të vijojë më tej.
Shqipëria është një vend i bukur dhe mikpritës!

Duke ju falënderuar edhe një herë për ftesën
për të marrë pjesë, më lejoni t'i uroj konfer-
encës suksese dhe punime të mbara!





Gjatë asistimit të ankesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas

komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Gjatë muajit Maj 2023, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun ka pritur 18 ankes, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe 25 telefonata me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit amanta.jasa@ild.al.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

*Gjatë muajit **Maj 2023**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **20 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuarit t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

ANKIMI NË ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion. Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë

në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.

- * mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.

MAJI NË ILD ME SHIFRA

Gjatë muajit **Maj** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar 85 ankesa, të paraqitura nga qytetarë.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Maj 2023**. Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

VERIFIKIME

14 vendime verifikimi, nga të cilat:

- ⇒ 5 vendime verifikimi (praktika të ILD-së);
- ⇒ 9 vendime verifikimi (dosje të mbartura nga ish KLD);

HETIME

- 1 vendim për fillim hetimi disiplinor për 1 gjyqtar
- 2 vendime për përfundim hetimi disiplinor për 3 gjyqtarë
- 3 vendime vazhdim hetimi disiplinor për 1 prokuror dhe 4 gjyqtarë magjistrat
- 1 kërkesë për procedim disiplinor për 1 prokuror


ARKIVIME

130 vendime arkivimi nga 153 praktika të shqyrtuara:

- ◆ 32 vendime arkivimi pas trajtimit të 47 praktikave të ILD, nga të cilat:
 - ⇒ 27 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;
 - ⇒ 5 vendime arkivimi pas verifikimit
- ◆ 98 vendime arkivimi nga 106 praktika të trajtuara (dosje të mbartura nga ish KLD):
 - ⇒ 65 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar;
 - ⇒ 33 vendime arkivimi pas verifikimit

SHPALLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Maj** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **34 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarritshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në standat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në standat e bashkive nga vijnë ankuesit. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në total ka bërë ka bërë 262 shpallje publike.



INFORMACION

Për shkak të rikonstruksionit të godinës, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvendoset për një periudhë kohore në adresën Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5, kati 3, Tiranë (tek Avokatura e Shtetit).

Oraret për komunikimin me qytetarët që duan informacion apo të paraqesin ankesë pranë ILD-së mbeten të pandryshuara. Ekipi i Zyrës së ankesave do i mirëpresë cdo ditë pune nga ora 09.00 – 14.00.

Pritja e qytetarëve do të kryhet në katin e parë të institucionit.



METANI VIZITË PUNE NË MALIN E ZI

Podgoricë, 4 Maj 2023

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani zhvilloi një vizitë pune pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë të Malit të Zi.

Në takime të vecanta, kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Vesna Simovic Zvicer dhe Prokurorja e Lartë e Shtetit, njëkohësisht Kryetare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, znj. Tatjana Begović, bënë një prezantim të kompetencave të institucioneve përkatëse dhe mënyrën e ushtrimit të tyre.

Në fjalën e tij, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nënvizoi mes të tjerash, se reformimi i sistemit të drejtësisë është sfidë e përbashkët e dy vendeve, në kuadër të procesit të integritetit europian, e sidomos në drejtim të orientimit të

shoqërive respektive, drejt një mendësie e kulture të re, lidhur me njohjen e zbatimin e ligjit, ndryshimin e mentalitetit në raport me kulturën e pandëshkueshmërisë, luftën ndaj korrupsionit, apo vetë shtetin e së drejtës.

Z. Metani iu përgjigj pyetjeve të bashkëbiseduesve mbi funksionet e ILD-së e në vecanti mbi procesin e ankimimit, hetimit e procedimit disiplinor. Ai vërejtë se sistemi i përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies së magistratëve duhet të funksionojë në një balancë ndërmjet interesit të publikut për t'u njohur mbi veprimtarisë e organeve të pushtetit gjyqësor dhe pavarësisë së magistratëve e gjithashtu, duhet të luajë një rol parandalues, përmes identifikimit të problematikave të funksionimit ose jo të sistemeve të drejtësisë, si dhe miratimit të rekomandimeve për përmirësimin e tyre.



“Sistemi disiplinor nuk duhet të shërbejë Duke qenë se Shqipëria po zbaton një reformë të asnjëherë si një mjet presioni mbi veprimtarinë e thellë ligjore e institucionale në sistemin e punës së magistratëve, por si një mjet i drejtësisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Metani rëndësishëm për të matur eficiencën dhe cilësinë ftoi drejtueset e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe e veprimtarisë së punës së tyre, profesionalizmin Këshillit të Lartë të Prokurorisë të Malit të Zi për apo të ndihmojë në rritjen e cilësisë së vendim- një vizitë në vendin tonë, me synim shkëmbimin e marrjes së magistratëve.”, u shpreh z. Metani. praktikave dhe modeleve më të mira të punës në kuadër të këtij procesi.





INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË VIZITË PUNE NË MAQEDONINË E VERIUT

Shkup, 30 Maj 2023 Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani zhvilloi një vizitë punë në Maqedoninë e Veriut, ku zhvilloi takime me kryetarin e Këshillit të Pro- Gjatë bashkëbisedimit u diskutua për standardet

kurorëve, z. Antonio Jolevski dhe anëtarë të Këshillit me Kryetarin e Këshillit Gjyqësor, z. Sashko Giorgiev dhe anëtarë të Këshillit.





e punës së prokurorëve e gjyqtarëve dhe sfidat të reja dhe përpjekjet që po bëhen në Maqedoninë e Veriut për reformimin e sistemit të drejtësisë në të dy vendet, me synim forcimin e besimit të publikut.

Në takimim me kryetaren e Gjykatës së Lartë znj. Besa Ademi dhe anëtarë të kësaj gjykate, z. Metani iu përgjigj interesit mbi reformën në drejtësi në Shqipëri dhe punën e institucioneve

Z. Metani zhvilloi takime pune edhe me kryetarin e Shoqatës së Gjyqtarëve të Maqedonisë së Veriut, z. Xhemali Saiti dhe kryetarin e shoqatës së Prokurorëve, z. Elvin Veli.





NDËSHKIMI I KRIMIT MJEDISOR NË VËMENDJEN E DREJTËSISË SË VENDEVE TË EVROPËS

Bukuresht, 19 Maj 2023 Eventi është pjesë e aktiviteteve të Rrjetit Evropian të Shërbimit të Inspektiveve të Drejtësisë (RESIJ), pjesë e të cilit është me statusin e vëzhguesit, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Pjesëmarrësit nga Inspektoratet e Drejtësisë së Francës, Italisë, Portugalisë, Rumanisë e Shqipërisë u mikpritën nga shefja e

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani mori pjesë në programin studimor në kuadër të projektit COPEIJ të Komisionit Evropian, "Bashkëpunimi për Mbrojtjen e mjedisit përmes Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë", në Bukuresht.





Inspektoratit rumun të Drejtësisë, znj. Roxana Ioana Petcu dhe u njohën me eksperiencën rumune në drejtim të luftës ndaj krimit mjedisor.

Botëror për Natyrën në Rumani, pedagogë e inspektorë të drejtësisë paraqitën kuadrin ligjor, problematikat, hetimin penal e sfidat e Rumanisë në luftën kundër krimit mjedisor në tokë e në det.

Drejtues të gjykatave e prokurorive, gjyqtarë e prokurorë, drejtues të gardës kombëtare të mjedisit, të policisë kufitare, të ministrisë së mjedisit, agjencisë për mbrojtjen e mjedisit (seksioni EMAS), të Fondit

Pjesëmarrësit zhvilluan një takim edhe me kryetarin e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe një vizitë pune në Inspektoratin e Drejtësisë të Rumanisë.



MAJ 2023


Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

© ILD



KONTAKT ILD

WEB: ild.al
EMAIL: info@ild.al
ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko për të ndjekur spotin prezantues të ILD](#)